



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Sektori I MZSH-së

PUNONJËS TË SHËRBIMIT TË MZSH-SË PËR NIVELIN BAZË NË SHËRBIMIT VENDOR TË MZSH-SË,SEKTORI MZSH-SË BASHKIA MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015,date 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe VKM nr.520 datë 25.07 2019 ”Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, “Emërimi,lirimi dhe përjashtimi I personeli të Shërbimit të MZSH-së”, vendimit Nr.08 datë 29.12.2022 “Për miratimin e strukturës, organikës, kategoritë/klasat e pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe të deleguara për vitin 2023, Bashkia Mallakastër njofton se në Sektorin e MZSH-sës shhpallen 1 (një) vend I lire pune në nivelin bazë në pozicionin:

- **Luftues/shpëtues** 1(një) pozicion,në nivelin bazë,

– Përshkrimi I përgjithshëm I vendit të punës;

Shërbimi I MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni I të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mara për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi I jetës,gjësë së gjallë,pronës,mjedisit,pyjeve dhe kullotave ne aksidente të ndryshme,fatkeqësi natyrore,si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Luftues/shpëtues,është personi i emëruar në stukturat e shërbimit të MZSH-së, I trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut,gjësë së gjallë dhe pronës.Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve,të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale,të jetë në cdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar rre zgjidhjen e situatave që ndodhin,të njohë dhe zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmerinë dhe abuzimin e mjediseve,teknikes, paisjeve etj,të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni,të jetë I sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë,me kolegët duke pasqyruar një figure qytetare dhe humane.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

-Kërkesat e përgjithshme për pranimin;

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mire shëndetësore edhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;

- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- e) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të jetë me vendbanim dhe vend qëndrim Brenda territorit të Bashkisë Mallakastër
- g) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- gj) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- h) Të ketë peshë trupore që ti përgjigjet raportit të gjatësisë.

-Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati I Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH-së.
2. Fotokopje e kartës së identitetit;
3. Saktësim adrese;
4. Certifikatë familjare;
5. Një kopje të jetëshkrimit (CV);
6. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
7. Fotokopje dëftese pjekurie;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (nëse ka);
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
11. Vërtetimi gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)/Formular vetëdeklarimi;
12. Fotokopje të librezës së punës e njëzuar me origjinalin (nëse ka);
13. Certifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
14. Dokument I lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues I lëndëve narkotike;
15. (dy) Fotografë (2.5 x 3.5 cm).

Aplikimi dhe dorëzimi I dokumentave bëhet pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër, brenda datës 28 Mars 2023.

-Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak;

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar I Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Mallakastër dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatit që plotëson kushtet e përgjithëshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër.

Kandidati I kualifikuar në lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohet në mënyrë elektronike/email-mesazh, për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave.

Kandidatët e pa kualifikuar do të njoftohen në mënyrë elektronike/email-mesazh për arsyet e moskualifikimit.

-Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi;

Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për qeverisjen vendore”

- Ligji nr.152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- VKM nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri “

-Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve;

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimi në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohet fazave të konkurimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testimi aftësive fizike;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- c) Intervistë me gojë;
- d) Testimi psikologjik;
- e) Verifikim përfundimtar I aplikantit.

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

-Testi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuri të dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.

-Testimi aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Pikët maksimale të përcaktuara për këtë test janë 100. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.

-Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për te komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

-Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të aplikantit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Kandidatët fitues do të renditen sipas nr.të pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Njoftimi I fituesit do të shpallet pas përfundimit të afatit të ankimimit.

BASHKIA MALLAKASTËR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

LAURETA SALIAJ

JONIDA LLAKA

MERUSHE QALLIAJ

